

Bën dimër i ashpër në Mokër

Muaji dhjetor paralajmëroi një dimër të ashpër, me rreshje dëbore e temperatura të ulëta. Pritet një keqësim i gjendjen në muajin janar

NE BRENDESI



MISTO MARKO E NJIHTE DHE E DONTE MOKRËN

Nga ZENUN FERRO

.....
 "Mokra" botoi raportin spiun të Pilo Peristerit, datë 1 shtator 1943

Krimbi brejtës në radhët e batalionit "Reshit Çollaku"



Nga Haki BALLIU



Mokra , 20 vjet demokraci

Nga Pellumb ZADE



Redaksia e gazetës "Mokra" uron të gjithë lexuesit e saj dhe gjithë mokratët, kudo ku jetojnë,

GËZUAR VITIN E RI 2011!

Suksese e mbasësi paçin në shtëpitë e tyre!

Një ditë nëntori në shkollën 9-vjeçare të Slatinës



Shqipëria, vend shenjtorësh

Nga Llazi TONA



Kalvari i familjes së Selman Biloshmit



Pogradeci feston!

Nga Koço PIHONI



Kolazhi "Dasma rrajcare", një arritje e këngëtarit strugan, Skifter Etemi

Një ditë nëntori në shkollën 9-vjeçare të Slatinës



Nga Sami LEKA

Duke udhëtuar për në Pogradec, takohem rastësisht në furgon me mësuesin e palodhur nga Baribardha (Debrova) z. Bexhet Korça. Mbasi u përshëndetëm miqësisht, ai më tha: "Xhaxhi Samiu, i kam ndjekur me interes shkrimet e tua në gazetën "Mokra", por, po munde, eja na bëj një vizite edhe në Slatinë, në atë kolektiv pedagogjik, mësues e nxënës ku punojmë, se kemi edhe shkollë të re". I premtova se në një kohë më të afërt do të shkoja në Slatinë. Dhe kështu bëra. Në një ditë nëntori mora rrugën për në Slatinë, një fshat i lashtë, me tradita dhe zakone të mrekullshme, i bujarisë, atdhedashurisë, i trimërisë, kulturës e artit, ashtu si gjithë Mokra.

Mbas Luftës nga Slatina u shkëputën fashtrat Vërrit dhe Zall – Torrë. Pak më herët nga ky fshat është shkëputur edhe Senishtit. U formuan fshatra të reja, të cilat janë edhe sot, ndonëse jo në me atë popullsi që kanë pasur dikur, para viteve 90-të. Në Slatinë ka ardhur gjatë Luftës mbi disa herë "Heroi i popullit" Reshit Çollaku. Në këtë fshat ai ka zhvilluar një aktivitet të gjerë për lëvizjen dhe zgjerimin e Luftës. Fjalët e zjarra të heroit ndezën prush zemrat e slatinakëve dhe gjithë fshatrave për rreth. Nga ky fshat dolën partizanë Rexhep Balliu, Asllan Leka, Arshim Leka, Xhevit Isufi, etj. Është plagosur gjatë Luftës dhe i ndjeri Shaban Alla dhe shumë të tjerë kanë qenë përkrahës dhe strehë për luftëtarët për liri.

Pas çlirimit, si kudo në Mokër, edhe këtu u hap shkolla fillore, në kushte shumë të vështira, me mësues Rexhep Kurtin nga Straniku. Rreth kësaj shkolle mësuan djem e vajza që kanë punuar e punojnë në të gjithë vendin. Mes këtyre nxënësve kanë qenë Haki Balliu, mokrari i nderuar e i respektuar që me shkrimet dhe librat e tij ka nderuar Slatinën e Mokrën. Novelat dhe tregimet e tij, që ndjekin rrugën 40-vjeçare të krijimtarisë së tij, janë një thesar i çmuar për brezat e rinj nesër. Nga ky fshat në vitin 1973 ra në krye të detyrës dëshmor i aviatori Islam Mani. Për të përjetësuar jetën dhe vepërën e tij shkolla 9-vjeçare mban emrin e tij, "Islam Mani". Nga kjo shkollë kanë dalë mësues të ndruar si Shefki Balliu, që më vonë punoi në radhët e ushtrisë, së bashku me të vëllanë, Hakiun, në poste të larta drejtuese, et të tjerë mësues si Lavdie Alla, Flori Slatina, tashmë një gazetar dhe autor i disa librave, Nafie Mokrëri, Bisera Alla, Lulëzim Mara, Çelik Balliu, Selim Leka etj. Kanë dalë mjekë si Barjame Çollaku, oficerë si Arben Balliu, apo ekonomistë si Shpëtim Leka, urim lasufi etj. Shkëlqimin e vet kjo shkollë e ka pasur në fund të viteve 70- e deri në mesin e viteve 80-të, kur drejtonte me shumë seriozitet dhe profesionalizëm, mësuesi i palodhur Ariz Fero. Në këtë shkollë ka pasur kuadro të nderuar, shumë të përgatitur profesionalisht

Shkolla e vjetër e Slatinës

si Xhevit Orhani, Tomorr e Mukades Gora, Sami Kapri, Tajar Begolli, Fadil Bylykbashi, Thoma Tasellari, etj, etj, madje në këtë shkollë ka dhënë mësim për një vit edhe kryetari aktual i bashkisë së Pogradecit, z. Artan Shkëmbi.

Slatina si fshat kufizohet në lindje nga bregu i Lules dhe bregu i Shemtirës, që e ndan nga fshatrat e Lakteshit, e Proptishtit. Ndërsa në perëndim kufizohet me Debrovën e Selishtën. Fshati është i futur në një luginë të mbuluara me pisha e drurë dushku që kanë formuar pyje të dendur. Burimet e ujit që dalin nga këto pyje furnizojnë me ujë të pijshëm thuajse çdo familje. Sot ky fshat është pjesë e komunës së Proptishtit.

Në qendër të fshatit ndodhet shkolla e re 9-vjeçare "Islam Mani". Kjo shkollë e re ka vetëm disa muaj që është ndërtuar mbi themelet e shkollës së vjetër, të ndërtuar në vitet 70-të. Për ndërtimin e kësaj shkolle një kontribut të veçantë ka dhënë komuna e Proptishtit, me kryetar z. Shaban Sula.

Në këtë shkollë sot punojnë arsimtarët Çelik Balliu, Selami Likollari, Bexhet Korça, Kalem Barçi, të vjetër në punë e me një përvojë të artë, e me një disiplinë të lartë shkencore.

Në bisedë të le përshtypje të veçanta mësuesi Selami Likollari, i cili në fushën e mësimdhënies, përdor një mori metodash të cilat atij i kanë dhënë rezultate shumë të mira. Prej përvojës së tij përfitojnë edhe mësuesit e tjerë më të rinj në moshë e në profesion.

Z. Çelik Balliu është n/drejtor i kësaj shkolle. Ai ka vite aty dhe shprehet me krenari se "të gjithë mësuesit e kësaj shkolle vijnë të përgatitur. Kemi një kolektiv mësuesish të ndërgjegjshëm për misionin e tyre dhe dinë të vlerësojnë punën dhe dijet e nxënësve të tyre. Madje mund të thuhet se ky kolektiv është ndër më të mirët i viteve të fundit, pasi pas viteve 90-të kjo shkollë ka pasur një rënie të madhe të cilësisë dhe kjo është normale. Kjo punë dhe ky përkushtim ka sjellë sot edhe rezultatet, pasi nxënës të kësaj shkolle vijojnë shkollën e mesme në Proptisht, vit pas viti dhe ky numër është i konsiderueshëm".

Sot nga kjo shkollë ka nxënës të daluar në mësim si Entela Mani, Sidorela Korça, Arsel Korça, Lorela Alla, Adirena Korça, Alba Korça etj. Duhet theksuar se në shkollën 9-vjeçare të Slatinës mësojnë edhe nxënës nga Selishta e nga Baribardhi, prej klasës së pestë e lart, pasi në këto dy fshatra shkolla fillore është deri në klasën e katërt, për shkak të numrit të ulët të nxënësve në këto dy fshatra.

Në fund një falënderim meriton edhe Suat Korça, i cili ka një kontribut për ardhjen e mësuesve në orar.

Me rastin e Festive të Nëntorit, nxënësit përgatitën edhe një program të shkurtër letrar – muzikor me recitime dhe këngë patriotike e festive.

Duke përfunduar këto pak rreshta i urojmë të gjithëve punë të mbarë, mësuesve nxënësve të mrekullueshëm, sukses në jetë dhe një vit të mbarë!

Kalvari i familjes së Selman Blloshmit

26 tetor 1944, pa u pushtuar Shqipëria nga bandat terroriste komuniste, u pushkatua Aziz Blloshmi, oficer me gradën major i diplomuar në Grac të Austrisë.

Në vitin 1946 - kësaj familje iu mor çdo pronë: tokat e bukës, kullotat e shtëpitë.

10 qershor 1952 - u arrestua Hasan Selman Blloshmi, u dënua me 20 vjet heqje lirie nën akuzën e takimit me "diversantë" (me Bardho Lekën - babai i Genc Lekës) dhe iu sekuestrua e tërë pasuria.

19 korrik 1965 - Hasan Blloshmi u lirua nga burgu i Burrelit.

Qershor i vitit 1954 - ndërroi jetë Selman Blloshmi.

29 mars 1963 - u arrestua Sami Selman Blloshmi nën akuzën për agjitacion dhe propagandë.

21 mars 1969 - Sami Blloshmi u lirua nga burgu i Spaçit.

Në vitin 1961 - u arrestua Bukurosh Selman Blloshmi, u dënua me 2 vjet heqje lirie sepse kur punonte në sharrën e Stravajit druri që po prisnin u ra mbi një tjetër duke e shkullur edhe këtë të fundit që nuk ishte damkosur për t'u prerë.

18 mars 1948 - lindi Vilson Sami Blloshmi.

1962-1966 - Vilsoni vazhdoi shkollën pedagogjike "Luigj Gurakuqi", Elbasan.

Në vitin 1966 - Vilsoni u diplomua si mësues, por nuk pati fatin të jepte as edhe një orë mësim.

1966-1969 - Vilsoni punoi druvar në Stravaj.

27 korrik 1967 - vdiq gjyshja e Vilsonit, motra e Bardho Lekës.

Dhjetor 1968 - dhjetor 1970 - Vilson Blloshmi krye shërbimin ushtarak në brigadën e punës, Tale - Lezhë.

1971-1973 - Vilsoni punoi në kooperativë ku bëri punë të ndryshme, duke filluar si bari lopësh e duke vazhduar me gjithfarë soj lopësh që kishte bujqësia.

1973-1975 - Vilsoni punoi në minierën e Përrenjasit, 1500m nën tokë.

Në fundin e vitit 1975 - Vilsonin e hoqën nga miniera dhe e kthyen të punonte në kooperativë.

Në nëntor të vitit 1975 - Vilsoni u martua.

1 prill 1976 - Bedri Blloshmi u arrestua.

5 gusht 1976 - Vilsoni Blloshmi u arrestua në urën e Librazhdit, i hodhën një batanije mbi kokë dhe e çuan në birucën nr.20, te burgu "Mine Peza" në Tiranë.

10 shtator 1976 - lindi Enerieta Blloshmi, vajza e Vilsonit

6 qershor 1977 - Genc Lekën, Vilson e Bedri Blloshmin i nxorrën në gjyq.

12 qershor 1977 - ora 10.00 u dha pretenca e prokurorit që kërkonte dënimin me vdekje, me pushkatim, për Genc Lekën, Vilson e Bedri Blloshmin.

13 qershor 1977 - u dha vendimi: Genc Leka u dënua me vdekje, me pushkatim; Vilson Blloshmi me vdekje, me pushkatim; Bedri Blloshmin me 25 vjet heqje lirie.

2 korrik 1977 - Kolegji i Gjykatës së Lartë la në fuqi vendimin e dënimit me vdekje.

16 korrik 1977 - Presidiumi i Kuvendit Popullor mohoi kërkesën për faljen e jetës.

16 korrik 1977 - Kadro Azbiu urdhëroi ekzekutimin e dënimit me vdekjes, me pushkatim më datë 17 korrik 1977, në mesnatë, 00.

17 korrik 1977 - Genc Lekën dhe Vilson Blloshmin i morën në mesnatë dhe i pushkatuan te vendi i quajtur "Përroi i firarit", 7-8 km larg Librazhdit.

27 korrik 1977 - Hasan Selman Blloshmi u arrestua për së dyti dhe u dënua me 10 vjet heqje lirie nën akuzën për agjitacion dhe propagandë.

7 korrik 1982 - Hasan Blloshmi vdiq në burgun e Spaçit.

23 janar 1982 - Bedri Blloshmi u transferua nga burgun e Spaçit në atë të Qafë barit.

22 maj 1984 - shpërtheu revolta në Qafbar kundër dhunës që përdorej mbi të burgosurit. Pas kësaj revolte u pushkatuan: Tom Ndoja dhe Sokol Sokoli, ndërsa Sandër Sokolin mbeti i vdekur gjatë kohës që po e rrinin policët e burgut.

5 korrik 1984 - Bedri Blloshmin e transferuan në burgun e Spaçit.

11 prill 1985 - ndërroi jetë diktatori.

12 prill 1985 - Bedri Blloshmin e thërritën në komandë ku e rrahën derisa e lanë pa ndjenja. U përmend vetëm kur ishte në birucë. Arsyeja e kësaj dhune ishte se kishte sharë "babanë e tonë" (Enver Hoxhën), se ishte gëzuar dhe priste ndryshime politike.

Korrik 1985 - Bedri Blloshmin e arrestojnë sërish dhe e çuan në birucën nr.7, Dega u Punëve të Brendshme, Rrëshen.

10 gusht 1985 - Bedri Blloshmin e nxorrën para kampit në Spaç, pasi e mbajtën 1 muaj të izoluar në birucë e çuan në burgun e Burrelit.

27 mars 1991 - Komanda e Burrelit kërkonte të lironte 10 veta me kusht. Bedri Blloshmi nuk pranoi dhe e kthyen përsëri në burg.

29 mars 1991 - Më në fund dyert e burgut të Burrelit u hapën për Bedri Blloshmin që pas kësaj dite e pa veten të lirë.

Në vitin 1994 - u bë e mundur gjetja dhe nxjerrja e eshtrave të Genc Lekës e Vilson Blloshmit ku mes kockave Bedri Blloshmi gjeti një nga plumbat që u mori jetën këtyre dy poetëve.

9 shtator 2003 - Nadire Blloshmi, nëna e Vilson e Bedri Blloshmit, ndërroi jetë.

Përgatiti: Bedri Blloshmi



Shtëpia ku u rrit Vilson Blloshmi. Sot është e kyçur dhe nuk rron njeri në të.

Nga Koço PIHONI

-Hapjen e Kanellave të Buteve me Verë për vitin 2010!

Në prag të festive të Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, Pogradeci e pogradecarët, prej disa vitesh radhas, festojnë këtë festë që ka si fillim datën 17 - 12 - 2010 për hapjen e buteve e si mbarim kohën kur thahen e nuk pikojnë më ata. Vlerësimi i këtyre festimeve e bënin më të dallueshëm, zburimet dekorativë, ndriçimet, zjarret në ambientet anësore të "Bulevardit 100 hapa larg Evropës" e cila ishte dhe epiqendra e kësaj feste tashmë e dominuar jo si aktiviteti i Bashkisë, por e gjithë qytetarëve e miqve të pranishëm në këtë festim, ku gjallërisht e mbështetur dhe nga dhjetëra njësi verëshitësish, qebabtoresh e pijetarë e pijedashës, shtoji dhe praninë e grupit të Këngës qytetare Pogradecare plotësonin ambientin festiv, ku dhe prania e rënia e borës të bënte të mendoje, sikur shikoje a përjetoje një përrallë të bukur, që jo të gjithë e kanë patur apo e kanë këtë fatmirësi do thosha është për çdo njeri.

-Zanafillën kjo festë e ka në lashtësi e Mitologji!

Gojëdhëna thotë se Perëndia, Zoti vetë pasi mbaroj shumë punë të mëdha, si krijimin e gjithësisë e më pas lindjen e jetës në tokë, kur njerëzia u shua e u shumua, atëherë Perëndia mendoi që popujve t' u caktonte territoret e vendbanimeve të tyre.

Dhe mbasi e kreu këtë detyrë, vendosi që për të vendosur Selinë e saja e të dishepujve e engjëjve të saj në tokë për t' u qetësua e argëtuat përzgjedhi në jetonte në pellgun ujëmbledhës të Lyknidas ku jetonte populli nga fisi i Ilir Enkelejtë. Popull ky punëtor, bujar e lirishtës. Prandaj dhe këtë vend e bekoj e i fali me bollëk, Ujra Fusha, Kodra e Male me lloje e soje gjallesa bimore e shtazësh, gjithçka që duhej për të jetuar i lumtur e në paqë me punë të ndershme. E nuk haroi Perëndia që në këtë pellg ta caktojë vendin origjinë e zhvillimit të hardhisë së rrushit dhe e bekoj atë e lëngun e Rrushit, Ai pat thënë: "Verën e bëftë kërcuri e piftë i Miri e i Urti"

Urdhëroj që ajo të bëhet pjesë e jetës dhe e gëzimeve në këtë vend. Dhe që "atëherë" thonë se në këtë nahi më shumë është pirë, Verë e raki se sa ujë!

- "Arkitekti" që idenë e ktheu në strategji për zhvillimin e turizmit gjithë vjetor.

Arkitekti më i mirë, ka për të ngelet i turpëruar përpara një krijese të vogël të natyrës sikurse është bleta e hojet e bëra prej saj, por edhe arkitekti më i keq dallohet prej saj, se ai para se të bëjë një projekt, duhet ta ideojë, mendojë më përpara se ta realizojë atë. K. Marks. Kështu do ta shpjegoja unë realizimin e shumë projekteve të mëdha që kanë marrë jetë e janë bërë realitet tashmë në qytetin tonë të ringjallur buzë liqenit. Kjo fal punës të qytetarëve, taksa paguesve e punonjësve të administratës së pushtetit vendor nën drejtimin e "Arkitektit" Kryetarit të Bashkisë që gjatë këtyre viteve bënë të mundur ringjalljen e tija qyteti. Më konkretisht. - Sjelljen në identitet të pastërtisë të ujit të Liqenit me përfundimi i Kolektorit të ujërave të zeza e të bardha, përfundimi i sheshit të qytetit e Bulevardit 100 hapa larg Evropës, përfundimi i infrastrukturës rrugore me parametra bashkëkohore, Shëtitortja për gjatë liqenit, Parku me lulishtet e mjediset e tija, mbjellja e mijëra pemëve dekorative në gjithë rrugët e mjediset, shtrimi dhe ndriçimi i të gjitha rrugëve e rrugicave të lagjeve të gjithë qytetit

Pogradeci feston!



Festa e Verës në Pogradec

Në datën 17 dhjetor u organizua në Pogradec sezioni i katërt i konkursit "Poezia e verës 2010". Në sallën kryesore të hotel "Enkelana" ishin vendosur dy bute me verë të kuqe dhe të bardhë. Nga çdo tavolinë u zgjodh një saki, të cilët së bashku zunë radhë pranë buteve për të mbushur kanat me verë. Kryetari i Bashkisë z. Artan Shkëmbi uroi mirëseardhjen. Pastaj poeti Dhimitër Pojanaku, moderator i konkursit, recitoi poezinë "Unë jam vera më e vjetër" dhe prezantoi jurinë të përbërë nga:

Bardhi Hyka, Kritik

Jonela Spaho, doktore e shkencave

Ilir Shyti, Master në letërsi.

Mes dhjetra pjesëmarrësve, poetë, shkrimtarë dhe amatorë të poezisë ishin aktorët e njohur, Marjeta e Rikard Ljarja, regjizori Mevlan Shanaj, poetesha Natasha Lako, akademiku Kopi Kycyku. Grupi "Nostalgjia" i traditës qytetare pogradecare interpretoi këngë për verën të kënduara prej vitesh në qytet. Mes ahengut dhe dollive për verën juria shpalli fituesit e konkursit.

Çmimi i parë: Sofokli Koçi me poezinë "Taverna e vjetër"

Çmimi i dytë: Marjana Shkurit me poezinë: "Duel me verën"

Çmimi i tretë: Eduart Sulollari me poezinë "Për verën"

Juria gjithashtu dha edhe këto çmime:

Çmime nderi:

Vangjush Ziko për poezinë: "Buti"

Sami Milloshi për poezinë "Vera".

Ndërkohë në bilevardin "Europa" qenë vendosur kioska druri që imitojnë kasollet e lashta, ku u ndezën zjarre dhe pihej verë me kernacka. Qindra qytetarë të Pogradecit dhe fshatrave përreth e kaluan natën në shesh.

Istref HAXHILLARI

në përgjithësi.

Ngritja e përmendoreve të dy korifentëve të letrave, Lasgushit e Mitrushit e kanë hijeshuar qytetin dhe e kanë bërë një nga më të admiruesit qytet të vendit, Opinione të shumta janë shprehura nga dhjetëra e dhjetëra qytetarë e turistë vizitorë vendas e të huaj. Ku unë do theksoja, jo më pak inpakt për zhvillimin e Pogradecit deri në vitin 2020! ka dhe do të ketë strategjia e përcaktuar tashmë prej disa vjetësh edhe si infrastrukturë për zhvillimin e një turizmi gjithëvjetor Elitar është pa dyshim dhe mbjellja e masiveve në kodrat e rrethinat e qytetit të kultivarëve me hardhi rrushi

të llojeve të duhura, zhvillimin e industrisë përpunuese të prodhimit të rrushit, marketimin, ambalazhimit e tregtimin e verërave e pijeve të tjera cilësore vendase. Faktor kryesor me ndikim në zënie e njerëzve me punë e ndikimi i saj në rritjen e mirëqenies për qytetarët e qytetit tonë. Dëshmi këto të një pune serioze të programuara e të përcaktuara në një plan tashmë afat shkurtër, mesëm e gjatë.

E gjitha kjo strategji e infrastrukturë është në funksion zhvillimi i turizmit vendor që ka tashmë për kryefjalë këtë festë vjetore promovuese që se ka asnjë qytet tjetër.

-Pogradeci feston!

"Hapjen e Kanellave të Buteve me Verë për vitin 2010"

Kjo festë tashmë është e kompozuar prej disa vitesh në dy ditë e dy netë!

Në axhendën e ditës së parë

Pritje në ambientet e zyrës së zotit Shkëmbi të qytetarëve të shumtë, si dhe të ardhurve e të ftuarve të shumtë nga e gjithë Shqipëria ku në këtë vit si asnjëherë më parë, dua të theksoj ka pasur të ardhur të shumtë nga Tirana veçmas personalitete të spikatur të Artit, Shkencës, Politikës e Biznesit, ku unë do dëshiroj ti falënderoj për mirëseardhjen. Miqtë e nderuar, Mevlan Shanajn e Natasha Lakon, Rikard e Marjeta Larja, Koço Devole, Filip Çakuli, Saimir Kodra e shumë foto reporterë, kameramanë e kinastë nga R Tv Shqiptar, për të vazhduar me deputetë të Kuvendit Shqiptar, zotërinjtë Taulant Balla e Fatbardh Kadilli e shumë personalitete të tjerë të ardhur.

Të pranishëm ishin bij të këtij qyteti Kopi Kycykun, Llambi Gegprifti, Hetem Fejzollari e shumë e shumë qytetarë e intelektualë nga shoqëria civile.

Më pas zoti Artan Shkëmbi, Marjeta Larja e të tjerë që i shoqëronin, përshëndetën e uruan qytetarët në ambientet festive tek përqendruar në Bulevardin 100 hapa larg Evropra pjesëmarrësit e shumtë e trokitën gotat me Verë së bashku me ta në atë natë të bukur nën flokët e asaj dëbore që të kujton vargjet e asaj kënge të vjetër pogradecare "Ra dëborë mbuloj catitë". Pijerarët si gjejnë dot shtëpitë. Më pas në ambientet e Bar - Hotel- Enkelanës u festua, Nata Poetike ku konkurruan e më pas u shpallën poezitë fituese kënduar pijes së Verës. Festim ky i iniciuar nga Bashkia e Kryetari i saj zoti Artan Shkëmbi. Ku festim e koktej i realizuar në prani të shumë qytetarëve e miqve të ardhur e të ftuar vazhdoi deri në mesnatë u zhvillua me shumë qytetari aty përshëndetën e interpretuan poezi artistë të ardhur dhe vendas të shoqëruar dhe nga trupa e këngës qytetare "Nostalgjia " Veçoj këngët "Rrokullisen butet", "Ajde verëshitës, më jep të pi", "Sa më pëlqen e shkreta verë" etj. Më pas Komisioni vlerësoi Poezitë më të mira e shpalli fituesit e kësaj nate poetike.

Po shkëpusim ca vargje ngap poezia fituese e Kocit:

Tavernën e vjetër me verë ta kisha,

Si kërmilli shtëpinë mbi shpinë

Sundimtar i botës do të isha,

Vetë Zoti do ma kishte zilinë!

Në respekt të shumë dhëndurëve të qytetit tonë të ardhur nga shumë qytete të vendit si Korça, Elbasani Durrësi, Tirana, Shkodra të shpallet e jepet një "Çmim " për dhëndrin më të mirë të ndodhur në këtë natë festive. Propozimi u pa me vend dhe titullin "Dhëndëri më i mirë", "Dhëndër Rrëk" u shpall pa kundërshti Rikard Larja i cili mori urime të veçanta nga pjesëmarrësit e dashamirësit e tij të shumtë ku ndër të tjerë Mevlan Shanaj u shpreh se ishalla e fitoj edhe unë një titull si ju atje.

Në Korçë në festën e Lakrorëve e të Birës. Duke përfutur nga ku rast dua të falënderoj pogradecarët e zotin Shkëmbi për pritjen e ngrohtë që na rezervuan dhe më lejoni të them se kjo mbrëmje kaq festive nuk gjendet e nuk realizohet edhe sikur të bësh me muaj të tëra prova teatrale. Unë kam marrë pjesë në shumë festime Më Vlorë, Elbasan, Tiranë, Korçë po kësaj lloj festimi "Rrëk" se bëhet gjëkund!

Në ditën e dytë të këtij festimi u bë dekustimi i shumë lloje Verërash Buti Nga komisioni i ekspertëve të ngritur nga Bashkia dhe u përcaktuan Fituesit për vitin 2010 të Verës së Kuqe e asaj të Bardhë ku fitues u shpallën Avdi Berberi, Musa Abrashi e Artur Blacëri. Në mbyllje të këtij shkrimi uroj lexuesit e stafin e kësaj gazete Gëzuar Festat e fund vitit Krishlindjet e Vitin e Ri 2011.

Gëzuar qoftë një vit i mbarë për të gjithë shqiptarët kudo që janë!

MISTO MARKO E NJIHTE DHE E DONTE MOKRËN

Nga Zenun FERO

Thonë se njerëzit je tojnë përmes historisë, kombet formohen përmes historisë, sjellja e jonë diktohet nga historia. Pogradecit nuk i mungojnë aspak dëshmitë për këtë histori të pasur. Një i tillë është shkrimtari Misto Marko (Mirash Markaj), i cili u nda nga jeta më 17 shtator 2010 në SHBA.

Në veprën letrare të Misto Markos ish i njohur me leximet që kisha bërë, ndërsa takimi i parë me të ka qënë 14 gusht 2006 në Pogradec. Në fillim takova dramaturgun Tomi Maton, i cili na dërgoi tek takimi me Misto Markon, Koço Pihoni dhe më vonë takojmë gazetarin e shkrimtarin Bardhy Berberin e shkrimtarin Maksut Çallo.

Biseda ishte e njëjtë me shkrimtarin Misto Marko, më prezantoi Tomi Mato, u dhurova nga një libër "Slabinja Jonë, Misto fliste me kulturë, i qetë, dhe i thjeshtë, kishe qef ta dëgjoje sepse fliste me një horizont të gjërë. Kishte mbaruar për mjeksi në Bukuresht në vitin 1953, dhe nga 1953 deri sa doli në pension 1989 punoi në Mokër, Pogradec, të gjithë e



njihnin. Të gjithë u hiqte dhimbjent dhe u shtonte jetën.

Me letërsi filloi që në shkollën e mesme, në shkollën e lartë dhe gjatë punës si mjek. Shkroi dramën "Pushtonjsit", "Natë e prasme e verës" fitoi çmimin e parë dramaturgjie në vitin 1974. Janë vënë në skenë

drama 'Besa e Madhe,, Udha e Flamurit,, "Vizitën e Milianderit,, Është dekoruar me urdhërin "Naim Frashëri,, të klasit dytë në vitin 1985. Romani i tij "Një idil i këputur,, në vitin 2000 u vlersua shumë nga kritika letrare.

Reportazhet tregimet, roma-

net e veçanërisht dramën u çmuan me vlersime të larta, si trilogjia, gjergj Kastrioti me çmim të parë në konkurs apo opera "Zgjimi, me çmim të tretë e të tjerë pasuan kulturën tonë kombëtare.

Bashkëshortëja, Astrita e Misto Markos, rrjedh nga një

familje qytetare e qytetit të Pogradecit, bija e Agllës dhe gazetarit dhe intelektualit Koço Semini.

Misto Marko ishte dajua i shkrimtarit Mitrush Kuteli, "Nderi i Kombit,, Pas vitit 1990, ishte veprimtar i shquar, sekretar i "Shoqatës miqtë e Lasgushit dhe Mitrushit" Kryetari Shoqatës "Feja me kombësinë dhe Nënë Tereza". Ai ishte i gjendur në çdo veprimtari shoqërore me fjalën e tij të bënte për vete.

Familja Marko ka pasur lidhje me Mokër, i vëllai i gjyshit Jovan Miti Marko ka qënë tregtar në vitin 1905 në Mokër, edhe gjyshi Spase ka qënë mbi 20 vjet në fshatrat Selca e Posh-tme, Proptisht e tjerë. Ka shkruar dramën për Zalltarët.

Misto punoi për shumë vite mjek në Mokër ku ka vizituar dhe shëruar shumë Mokrarë.

U ndamë me doktor Misto Markon, në Pogradec duke bërë një fotografi kujtimi, më 14 gusht 2006, dhe poeti Maksut Çello. Ai tani prehet që më 16 shtator 2010 në SHBA, tani e tutje për t'u çmallur do të lexojmë librat dhe kujtimet. Puna dhe vepra e tij nuk do të vdesin, ato janë gjallë në Pogradec, në Shqipëri e SHBA.

ESKURSION NË SHËNAUN, OHËR E QUKËS NGA KONSULLI FRANCEZ AUGUSTE DOZON

Nga Zabit CUKU

Në vitin 1878 konsulli francez Auguiste Dozon, një nga albanologët evropianë më në zë të shekullit XIX, kras Hahn, Reinold, Mayere, Jarnik, apo Pedersen krijoi një lidhje të veçantë me Shqipërinë dhe shqiptarët. Fillimisht u interesua dhe mbledhi këngë e përralla shqiptare, u josh dhe i'u fut studimit të shqipes, duke krijuar përgjithmonë një marrëdhënie të veçantë me këtë gjuhë e kulturë.

Kujtimet e këtij albanologu të madh i gjejmë edhe shënimet e një udhëtimi të gjatë nga Janina deri në Shkodër, përpiloi përshtypje dhe detaje të manihshme që ai i botoi në librin Eskursion në Shqipëri. Kujtimet e Angaste Dozon në Shënaun, Qukës, Elbasan, po i japim të shkurtëra.

Aguste Dozon tashme do të shkojë drejt Shën Naumit, të cilën pas shumë e shumë orësh më së fundi e shikon buzë liqenit, të ngritur mbi një pjesë shkëmbore. "Unë kasha dëgjuar shumë për Shën Naumin, shkruan ai por pamja e tij, brënda e jashtë, më habiti pa masë. Për të ndenjur më dhanë një dhomë që ishte e veçse një kthinë që lagej nga shiu, pasi prej disa orësh stuhia jashtë sillte shiun brenda. Në fakt dhomat ishin për të huajt e pelegrinët, por ato ishin djegur para ca kohësh dhe tani po i rindërtonin. Në manastir ka vetëm 4 murgj, tre drejtuar nga një grek i Kretës, një plak i sëmurë, i cili ka këtu që prej 27 vjetësh, pasi kishte lënë manastirin e Sinait. Por si ndihmës, kishte një "qahja" laik. Nga Shën Naumi, Dozon-i vazhdon rrugën drejt Ohrit, pastaj Strugë dhe që andej, drejt luginës së Shkumbinit, nëpër male, për të zbritur në Qukës, nga ku kalon rruga për të gjithë udhëtarët që kalojnë nga ato anë.



"Një fshat me njëzet shtëpi me dy hane dhe një postë zaptijesh (xhandarësh) të cilët i kishin bastisur disa ditë më parë" Ndishta për tu marrë armët!... "Lëmë luginën dhe 6 orë më pas mbërrijmë në Urën e Beqarit..."

Dozon-it i pëlqen pazari i Elbasanit, duke shënuar se më parë kristianët nuk kishin të drejtë të kishin dyqanet e tyre, port ash kohët kanë ndryshuar. Pesë-gjashtë dyqane kristiane janë përzier mes të tjerëve. "Por kureshtja e vetëme që të afron ky Pazar janë dyqanet e armëve. Aty ndihesh vërtet në shqipëri. Armët evropiane ende nuk kanë ardhur deri këtu. Pushkët janë akoma me "gurë" dhe tepër të gjata". Dozon-i vëren se Elbasani ka dy lagje kristianësh, ku secila nga ato përmbledh rreth 100 shtëpi dhe nga një kishë. E para është ajo e banuar nga shqiptarët kristianë të rritit "oriental", pra e kishës ortodokse, e dyta ajo e vllëve. Peshkopi i cili është edhe i Durresit, banon në lagjen e shqiptarëve, vëren Dozon. Dioqeza e tij përmbledh veçse 1200 shtëpi të shpërndara nëpër qytete e fshatra të ndryshme. Dikur Posta Telegrafike këtu kishte një punonjës francez, i ngarkuar për shërbime në gjuhët e huaja, por më pas e kanë hequr si këtu ashtu edhe në Prevezë, ç'ka ka sjellë ankesa të përgjithshme dhe legjitime.

EDHE VJERRI I RESHIT ÇOLLAKUT ARRESTOHET NGA GESTAPOJ-ja

Reshit Çollaku në kohën e Luftës Antifashiste Nacionale Lçirimtare ishte fejuar me të bijën e Qazim Kokoshit, një nga 40 firmëtarët e firmosjes së Deklaratës së Pavarsisë më 28 nëntor 1912. Familja Çollaku në Pogradec ishte lidhur me familjet patritoke në Shqipëri, ajo ka zhvilluar një aktivitet të madh patriotik, që për këtë është shkruar në gazetën "Mokra" në numrat që kanë dalë.

Bija e Qazim Kokoshit i qëndori besnike Reshit Çollakut edhe pasi u largua nga jeta në luftën e Pojskës në 16 korrik 1943. Ajo nuk u martua dhe për këtë familja Çollaku, Pogradec gëzojnë një respekt të madh. Dashurinë e saj me Reshitin e mbajti deri sa u largua nga kjo jetë. Shkrimi në këtë gazetë është për jetën e vjerrit të Reshit Çollakut, Qazim Kokoshin.

Lindur në qytetin e Vlorës dhe mësimet e para i mori në shkollën turke të qytetit të Vlorës dhe më pas shkoi në Janinë, ku mbaroi gjimnazin "Zosimea". Pas mbarimit të asaj shkolle aty rreth fillimit të viteve 1900 u kthye në vendlindje dhe u angazhua në Klubin "Labëria", ku punoi për përhapjen e gjuhës shqipe në fshatrat e Vlorës. Mori pjesë në kuvendin e Vlorës në nëntor 1912, si delgat i Vlorës. Firmoi aktin e pavarsisë me siglën "Qazim Kokoshi". Në gusht 1913, Qeveria e përkohshme e Vlorës, e caktoi me detyrën e nënprefektit të Lushnjës. Pasi punoi afro shtatë muaj në atë detyrë, në shkurt 1914 u emërua me detyrën e kryesekretarit të Prefekturës së Vlorës. Pas rënies së Qeverisë Vlorës u caktua antar i delegacionit për tu takuar me Princ Vidin. Konkuroi në zgjedhjet parlamentare që u zhvilluan në vitin 1921, ku dhe u zgjodh deputet i Parlamentit të parë Shqiptar. Pas tre vitesh në Lëvizjen e Qer-



Bija e Qazim Kokoshit i qëndori besnike Reshit Çollakut edhe pasi u largua nga jeta në luftën e Pojskës në 16 korrik 1943. Ajo nuk u martua dhe për këtë familja Çollaku, Pogradec gëzojnë një respekt të madh.

shorit të vitit 1924, u bashkua me grupin opozitar që udhëhiqej nga Fano Noli e Luigj Gurakuqi. Pas dështimit emigroi në Itali e më pas në Austri. Më 1928 u kthye në atdhe pas amnistisë së mbretit, por në vitin 1932 u arrestua me akuzë komploti kundër Zogut dhe u burgos, për të dalë sërish më 1936. Pas vrasjes së dhëndërrit të tij heroit të Popullit Reshit Çollaku (i shoqi i së bijës), Kokoneshi u arrestua nga GESTAPO-ja dhe u internua në Bergamo. Në prill 1946, komunistët arrestuan Qazim Kokoshin i cili ishte kthyer në Shqipëri nga internimi nazist në vitin 1945. I izoluar në hetusinë e Vlorës ai vdiq nga torturat.

Zenun FERO

“Mokra” botoi raportin spiun të Pilo Peristerit, datë 1 shtator 1943

Krimbi brejtës në radhët e batalionit “Reshit Çollaku”



Nga Haki BALLIU

Monedha e krenarisë


Kam një konflikt me kujtesën, të kaluarën e ruan me kujdes, të sotmen shpesh e le jashtë vëmendjes. Mbase është arsye moshe, malli apo nostalgjie. Ja ku po perëndon ky vit dhe mendimi qartësisht shkon te ata që mëngjeseve rinore më kanë bërë më shumë për vete. Kësaj radhe nisa të hedh ca radhë për mbresat që më kanë lënë shokët e shefat e mi më të hershëm, në Propolishtin e viteve 50-të, ku mësova ç’është puna dhe rregulli me të cilën më duhej të ecja në jetë.

Mirëpo më befaskan zërat e ardhur që nga Pogradeci. Dikush prej derës së nderuar të Reshit Çollakut, dy të tjerë nga radhët e veteranëve, pastër thanë: “Pse Haki Balliu nuk reagon ndaj shkrimit dossier, botuar te “Mokra”, gusht 2010?”

Kështu, pra, jam “i detyruar” të bëj patriotin, sigurisht jo pa dëshirë. Fillesa e kujtesës sime lidhen me Mokrën e kohës së luftës. Nuk e fshih se monedha e krenarisë së fëmijërisë sime mbeten momenti kur piquesha me çlirimtarët, veçanërisht një ditë korriku kur u ndodha pranë legjendarit Reshit Çollaku.

Ai erdhi vetë i tretë, siç do të mësohej më vonë, shoqërohej nga prifti i Llëngës dhe Pilo Peristeri. U ulën poshtë shtëpisë në arën me misër, nën hijen e arrës së madhe. I djegur prej kuriozitetit vrapova tek ata. Më i riu ndër ta, mbasi më pyeti nëse isha çuni i Shegës (babai na kishte lënë të vegjël, u nda nga jeta atë vit që filloi Lufta), më tha buzëqeshur: “Shko e thuaji “Ke të fala nga Reshiti!”. E mira nëna ime e mbante saçin në zjarr. Më dha tepsinë me byrek, sipër vuri ca bukë misri me djathë, një sheqe me dhallë dhe tri lugë druri të papërdorura.

“Rritu shpejt, o balli i vogël, se atdheu mbrohet me ushtarë!”, më përkëdheli Reshiti duke ikur. Ai çast ruhet ngujuar në ndjesinë time. Prej aty komandanti i Mokrës martire, së bashku me komisar Pilon, nisej në betejën e



Isuf Çollaku me gruan dhe djemtë e tij. Foto e viteve 30-të

Pojskës. I pari dha shembullin e heroit, i dyti luajti rolin e lepurit në ferra. Kështu qe Pilo Peristeri.

Pabesia e Pilos

Raporti i tij i datës 1.09.1943 drejtuar Shtabit të Përgjithshëm, jeton akoma në qypin e zi të historisë. Një dashamirësi gazetës sonë e serviri për ta njohur. Staf i gazetës e lexoi dhe materiali u botua në muajin gusht, me qëllimin të demaskohej pabesia dhe hipokrizia, me të cilën Pilo Peristeri qëndroi 33 vite deputet mbi kurrizin e Mokrës.

Cila është përmbajtja e shkurtër e raportit fiktiv të shkruar në skutat errëta? Një arsenal shpifësh derdhen në shpinën e Muharrem Çollakut, të cilin mokraret e kishin në zemër dhe për zemër ta vinin komandant batalioni, në këmbë të vëllait. Heqjen e tij qafe del qartë kur shkruhet: “Muharremi ishte shprehur se nuk duron të ketë mbi kokë Pilon dhe Tuku”. Fesati, shkruan Pilo, u kap në konferencën e datës 29.08.1943 ku pjesëmarrësit dhe paria e Mokrës u vunë kundër udhëheqjes së batalionit. Këta zgjodhën një përfaqësi prej 25 vetësh dhe u nisën t’i imponohen Shtabit të Përgjithshëm. Po urithi i Enverit me vizion të errët u struk nëpër hijet e natës të përgjonte bisedat se kush e donte e kush e luftonte Muharrem Çollakun, Mokraret e dalë malit për liri, ashtu të shkujdesur uleshin e çlodheshin këmbëkryq mbi lëndinë, me pushkët mbi gjunjë e çibukët në buzë. Të sinqertë e të padjallë-

zuar flisnin gjithçka u ndjente shpirti për aktin e Reshitit dhe lëvdonin të vëllanë, Muharremin. Piloja, në vend të dashamirësisë, mbushej me vrer, të cilin e derdhte në rrethin e tij më të ngushtë. “Shkruaji Shtabit të përgjithshëm”, del t’i ketë thënë Tuku. Piloja vuri në majën e lapsit, si në grykën e pushkës, burrat e dëgjuar, atdhetarët më të zjarrtë të krahinës: Isuf Çollakun me të birin, Muharremin, Tele Baçin, Murat Isufin, Liko Gjonën, Et’hem Haxhiun, etj. Të gjithë i futi në një kallëp, u veshi të njëjtat cilësi negative si të kishin pirë qumështin e së njëjtës nënë. Ja cilësimet: egoistë, tarafxhi, hajdutë, gënjeshtarë, të fëlliqur, mercenarë, kriminelë, krokodilë, të lindur për hakmarrje etj, etj.

Ndër këto epitete, më shokuese janë trillimet mbi figurën e Muharrem Çollakut. Për një shaka mes shokës, për një ide taktike mbi luftën, një kundërshtimi reale ndaj qulltësisë së vetë komandës, lapsi i Pilos, ngre lumin e akuzave për të bindur komandën Qarkut të Korçës dhe Shtabit të Përgjithshëm. “Muharremi të mos bëhet komandant batalioni!”, por pranohej e keqja më e vogël, të emërohej zv/komandant. Arsyetohej kështu se Muharremi i kishte partizanët për vete dhe mund t’i merrte me vete. “S’kemi ç’bëjmë, këtë brumë kemi!”, shkruhet tekstualisht. Sipas tij brumi që nuk gatuhej ishin njerëzit e përkatësisë myslimane.

Në mëngjesin e datës 1 shtator 1943, korrieri partizan futi në

gji raportin shpifarak dhe nisete për në Korçë, por më parë se ai arrin te Enver Hoxha delegacioni Liko Gjonës. “Pse je lodhur gjer këtu, xha Liko?!” - e ka pyetur ai.

“Po të bëjmë një rixha të madhe”, o komandant”, - i thotë Liko Gjona. Duam Muharremin komandant!”

Dihet si shkoi puna. Ca me naze, ca me lajka, me hir e me pahir, mokraret e mençur triumfuan paqësisht. Muharrem Çollaku drejtoi luftimet në batalionin që i la i vëllai dhe plotësoi amanetin e tij të dhënë përpara Pojskës: “Ka vdekje e vdekje, po lum kush vdes nën fluturimin e plumbave për vendin e tij!”.

Pilo kovaçi, siç e ironizonin që atë kohë, nuk pati kurajë të pështyjë veten kur pa se si luftoi e si ra biri i dytë i Isuf Çollakut. Edhe Muhiharremi, ashtu si Reshiti, përballë autobindave, u vra nga forcat naziste në një luftim, më saktë në garë me vdekjen, se kush do të kapte i pari atë lartësinë dominuese mbi Pogradec.

Shqetësimi që ngjalli dokumenti i Pilos për familjarët sot, është edhe shqetësimi ynë. Nuk e ndiej nevojën të moralizoj për ata, sepse secili prej tyre vjen nga familje të mëdha, patriotë e fisnike. Të paktën Isuf Çollaku, Liko Gjona, Murat Isufi dhe djemtë e tyre i kemi mik shtëpie. Nga goja e veteranëve të luftës fjalë të mijëra, aq edhe përgjërime kemi dëgjuar gjithashtu edhe për Et’hem Haxhiun, e Tele Baçin, të likuiduar qysh në vitet e Luftës nga njerëz si Pilon e shokët e tij. Familjeve të tjera radha do t’u

vinte pas Luftës, kështu fjala sjell fjalën e fjala prek dhimbjen, zhgënjimin, ndjesinë e fajit...

Si e duruam 33 vjet deputet?!

Si ky dhjetor, 57 vjet më parë, në takim me popullin e lokalitetit të Propolishtit, erdhi edhe deputeti i zonës. Emrin e tij e admiroj shumë, por nguroj ta shkruaj pasi dikur do të “vetëzgjidhte” fundin tragjik. Në atë takim me zgjedhësit ai vinte të mblidhte ankesat, si të ishte mblidhës folklori. Më kujtohet se njerëzit u ulën në shesh, aty ku lartësohet komuna e sotme. Çuditërisht ankesat ishin tepër të kufizuara. I varfëri nuk u ankua se kishte uri. Gratë nuk kërkuan mami. Ndërhyri këshilltari e bëri thirrje: “Flisni, shoku deputet ka ardhur t’i qajmë së bashku hallet!”

Deputeti u drejtua një plake me shami të zezë: “Ja, le të flasë ajo nëna aty!...” E fortë në fizik e në fjalë, ajo u ngrit e tha: “Unë kam qarë, po nuk qahem. Kur qava në luftë, s’kam pse të qahem në çlirim”. E tillë ishte aso kohe psikologjia e mokrarit, i robëruar prej luftërave, i mësuar prej vuajtjeve, i pamësuar me qarje e ankesa. Edhe atë deputetin që vinte të dëgjonte pretendimet e jo të na mashtronte me premtime, mos e merrni për Pilon. Ai ishte i madhi Piro Gusho. Atë ditë unë fola diçka të vogël që atij i pëlqeu, e prandaj më mori me vete të pinim kafe në zyrën e Faik Kaprit. Mes tyre bisedohej për Pilon, i cili në legjislaturën e ardhshme do të hypte në vend të Piros.

Me mbresat ndodhka t’i marrësh më shumë atij që e njeht një çast sesa atij që e ke çdo javë në sy. Kur mësova tragjedinë e Piro Gushos në vitin 1974, u shokova duke pyetur heshtjen e zezë: “Si ishte e mundur të vetëvritej një vigan si ai?” Atëherë deputeti ynë i dikurshëm ishte i pari i Fierit. Në një aktiv partie, një byroist shkurtabiq, që mbante emrin tim, pastë hijen e tij, ndërseu muzeqarët: “Turruni Gushos se ka sabotuar në ekonomi!”. “Ka sabotuar?!, e po çfarë?!” - thanë ata. Pirua e mbylli jetën me pistoletën e vet. Ku ta dish? Flitej se vetëvraska e Piros ngeli gëzimi i varur në buzët e Pilos. Po si vallë duruam mbi kokë 33 vite deputet? Sepse jetëgjatë qe vetë diktatura për të cilën Pilon lutej sa herë vinte 16 tetori. Në bisedat e mërzitshme Pilon nuk harronte t’i binte faqes së vet e të thoshte: “Unë do të jetoj 89 vjeç”. Vitet mbi to nuk shprehej kujt do t’ia falte, por dihet se ai preku shekullin. Deri para dy vjetësh pensionin e merrnim tek e njëjta arkë kursimi.

(vijon ne faqen 8)

Mokra, 20 vjet demokraci

Nga Pellumb ZADE

Sigurisht, është një ditë tepër e gëzueshme. Për të qenë e lirë, Mokra në shekuj është përballur me sakrificat e shumta. Ne

përgjithësi, popujt e zonave të thella malore, nuk e kane pranuar shtypjen e të huajve, natyrisht, Mokra, jo vetëm që nuk mund të bënte përjashtim nga ky rregull, por ka qenë një shembull edhe për të tjerët. Koshadhet turke, falangat serbe, ushtritë e huaja austriake, hungareze, bullgare etj. në Luftën e Parë Botërore, edhe se e kane masakruar, asnjëherë nuk janë ndjere të qeta nga populli mokrar. Edhe në Luftën e Dytë Botërore, populli i Mokrës, u ngrit në këmbë kundër pushuesve italianë e atyre gjermanë, pa dallime politike e fetare. (Pavarësisht shpifjeve monstruoz të renegatit Pilo Peristeri që hedh balte mbi burrat e familjet me të nderuara të Mokrës), luftoj e dha shume dëshmorë për atë të uruar liri e demokraci, por që nuk e gjeti dot. Sistemi 50-vjeçar komunist, e zhduku me themel këtë nocion, duke instaluar një bllokade masive politike e ekonomike për popullin e vet.

Natyrisht, populli mokrar nuk u pajtua me këtë sistem politik. Me dhjetëra qenë të pushkatuarit, burgosurit e internuarit politike në këtë sistem, deri sa erdhi momenti i shumë prituri, dhjetori 90, për të shpërthyer një lëvizje e gjerë popullore, me objektivin për ta bërë Shqipërinë të lirë e demokratike, e ku sigurisht, populli i Mokrës dha një kontribut të pamohueshëm e me vlera historike. Kjo lëvizje, që mjaft e gjerë e popullore, ku morën pjesë



mjaft intelektuale, punëtore, kooperativiste, studente etj., që tregonte se pakënaqësia e popullit ndaj sistemit diktatorial ishte e plotë, masive, e nuk kishte me prapa ktheu.

Protagonistët mokrarrë që u angazhuan në këtë revolucion janë të shumtë, por unë në cilësinë e njërit prej nismëtarëve të saj, do përmendja pararojën e tyre, ata që në shi e në borë, ditën e natën, pa mjete transporti e komunikimi, nuk u thyen për asnjë çast nga presionet e shoqatat antipopullore e të rrezikeshme të krijuara nga sistemi i diktaturës në agoninë e tij, si p.sh. "Shoqata e Enverit" etj. Por ata vazhduan luftën e tyre deri në fund, që do të thotë zgjedhjet politike të 22 marsit 92, ku Partia Demokratike korri një fitore të madhe historike.

Se pari, nuk duhet të harrojmë për asnjë çast, se Mokra ka edhe dëshmorin e saj të demokracisë, ish-studentin Shpetim Elmasllari, që me gjakun e tij të kuq vulosi fitoren e madhe popullore. Në përulëmi sot me respekt të thellë para aktit dhe veprës së këtij dëshmorë. Në këtë pararoje, duhet veçuar mjeku kirurg, Eqerem Zyferi, kandidati i parë për deputet i Partisë Demokratike në zgjedhjet parlamentare të vitit 31 marsit 1991, si dhe mjeku Petrit Leka, kryetari i parë i Partisë Demokratike për rrethin e Pogradecit në vitet e vështira 91-92. Mirënjohjen më të thellë për Dr. Misto Marko, që edhe se nuk ishte i lindur Mokrar, nuk la fshat e shtëpi një fitore të madhe historike.

të gjithë zonën. Një falënderim dhe homazh për këtë intelektual të shquar që u nda nga jeta në prag të 20 vjetorit të lëvizjes demokratike dhe përmbyesjes së diktaturës.

Janë intelektualët Përparim Isufi, Fahri Muço, Miallaq Maçolli, Petrit Çela, Shaban Sula, Elsa Zyferi, Myftar Spahiu, Neki Laraku, Ibrahim Baçi, si dhe punonjësit, Xhafer Hasanaj, Elez Zade, Ali e Sami Muço, Ferit Xhika, Tosun Spahiu, Sami Male Muço, Bedri Turtulli, Guri Burnazi, Sabri Abeshi, Jaup e Samit Fezollari, Hyqmet Baçi, e shumë të tjerë që u kërkoj të falur pasi nuk i mbaj mend emrat nga koha e largët, njëzet vjeçare. Qenë

pikërisht këta militantë që bënë të mundur krijimin e Partisë Demokratike në të gjitha fshatrat e Mokrës në një periudhë shumë të shkurtër, kur kishte rreth e zona të mëdha urbane që nuk e kishin arritur këtë sukses.

Natyrisht, me ndërrimin e sistemit politik, rezultatet demokratike qenë të menjëherëshme. Tani, askush nuk dridhet me nga frika se mos pa dashje i shpëton ndonjë fjalë pakënaqësie për brigadierin, se nuk ia mati mirë punën e kryer, për furrxhiun, se nuk e ka bërë bukën e mirë, për mungesën e ushqimeve, për punën e rëndë fizike e të tjera absurditete fatale si këto, mbasi kanë qenë jo të paktë ata që kanë bërë dhjetëra vite burg politik, vetëm për një fjalë goje. Secili mokrar nuk është i detyruar të punojë e të jetojë atje ku "ka nevojë Partia," por është i lirë të zgjedhë vetë vendin ku mund të ketë një jetesë më të mirë. Tani, duke qenë anëtarë të NATO-s, nuk kemi nevojë të hapim trashë e bunkere nëpër male, në bore e akull, nga frika se "po na sulmojnë imperialistët e revizionistët". Tani mokrarët nuk i vret më ushtari ynë në kufi se "po tradhetojnë atdheun", duke kërkuar një jetë më të mirë, madje këtë vit, me fitoren e madhe të heqjes së vizave, popullsia e zonës, do ketë mundësi reale për të shkuar në vende të ndryshme të Evropës, për t'u takuar me të afërmit e tyre në emigracion, apo për dëshira të tjera.

Këto e shumë të tjera, na japin të drejtën të krenohemi për sakrificat e panumërta që populli i Mokrës kaloi për demokratizimin e saj.

Në numrin e ardhshëm 144, janar 2011, do të lexoni:

INTERVISTË E AKADEMIKUT PROFESOR DOKTOR KOPI KYÇYKU, DHËNË GAZETARIT LLAZI TONA

Akademiku Kopi Kyçyku, si enciklopedist që kërkon të dijë gjithçka, është kthyer në krenari, jo vetëm për vete, por krenari edhe për të tjerët. Me një veprimtari të gjerë dhe të thellë shkencore, ai nuk jeton vetëm për vete, por për njerëzimin. Akademiku Kopi Kyçyku është futur thellë në labirintin e dijeve nëpër viset e Ballkanit, Evropës dhe botës. Kur e pyetën Aleksandrin e Madh të Maqedonisë: "Përse depërtove aq larg, deri në Indi?", ai u përgjigj: "Na thonë se qenkemi indoevropianë. Deri sa është kështu, atëhere kufijtë e Evropës mbarojnë në Indi". Edhe miku i dijes, akademiku Kopi Kyçyku, mbasi mbaroi një varg studimesh shkencore në shumë vende të Evropës, si: Rumani, Greqi, Kroaci, Bullgari, Maqedoni, Zvicër, Francë, Gjermani etj, shkoi për të hulumtuar në Turqi, në Indi e gjetkë.



Shënim: Poezitë e botuara në numrin e kaluar janë nga Jeton MUÇOLLARI

Kryeredaktor: Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"

Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës

Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

www.poradeci.com/mokra




HOTEL "PERLA"

Hotel Perla * - Hoteli i ndërtuar krejtësisht i ri, i mobiluar me shije dhe i menaxhuar në mënyrën e duhur, ndodhet buzë Liqenit të Ohrit, përgjatë shëtitorës së qytetit, 20 m nga plazhi i Pogradecit. Ju mirëpret në Bar, Restorant, kuzhinë të pasur, muzikë romantike në sfond. 9 dhoma, 1 apartament, TV, Shërbim dhome, Telefon**

Address:
Rruga "Deshmoret e Pojskes",
Lagja 1, Pogradec, Albania

Tel. +355
0682320160
0692390220
Fax: +355
0832 6688



Shqipëria, vend shenjtorësh

Nga Llazi TONA

Shqipëria, me një popullsi të lashtë, më e lashtë se vetë lashtësia, me një popull me histori mbi 2000-vjeçare, një popull me origjinalitetin e vet, mbushur me shumë shenjtore, të cilët dhanë jetën e tyre në shërbim të njerëzimit e veçanërisht të këtij populli. Me rastin e festës së bukur të Lindjes së Krishtit, po botojmë shkrimin e mëposhtëm, na njeh shkurtimisht me disa prej tyre dhe njëherësh urojmë të gjithë besimtarët e krishterë gëzuar Krishtlindjes dhe një vit mbarësi e lumturi paçin në familjet e tyre!

Shën Asti

Shenjtore i krishterë i Shqipërisë. Njihet si peshkop i Durrësit në kohën e perandorit Trajan (sund. më 98-117 të e. Re, një nga 70 nxënësit e Jezu Krishtit. Simbas gojëdhënës, u arrestua nga guvernatori romak i Durrësit, Agrikola, dhe u torturua për vdekje rreth vitit 98 të e.r), ngaqë nuk pranoi të adhuronte perëndinë Dionis. Kremton më 6 korrik ose më 4 qershor.

Shën Lefteri (ose Elefteri)

Shenjtore i krishterë i Shqipërisë. I emëruar peshkop i Mesinës dhe i Ilirikut kur ishte njëzet vjeç, me sa dihet u ngul me banim në Vlorë. Simbas gojëdhënës, ishte tërhequr në Romë ku u martirizua rreth viteve 117-120 të e. r., bashkë me të emër Anthia dhe me njëmbëdhjetë shokë gjatë një fushate kundër krishterimit në kohën e perandorit Hadrian (sund. 117-138 të e. r.). Kremton më 18 prill.

Shën Marena

Jetoi në kohën e Perandorit Aurel. Është shenjtore e krahinës së Mokrës dhe rrethinave të saj. Dy kanë qenë cilësitë e saj: shpëtimi dhe drejtësia. Që në moshë të re bëhet e krishterë në kartelën e Llungës (Llëngës), hyn në besën e Krishtit. Me punën e saj me njerëzit, në bisedat kokë më kokë për vlerat e krishterimit, ndërgjegjëson mokratët dhe i bën ata që të përqafojnë krishterimin. Për këtë arrestohet dhe torturohet në mënyrë çnjerëzore, deri në vdekje. Për këtë zëjtarët, rrobapësit, kasapët, e mëdhenj e të vegjël, blegtorët e tregtarët e qytetit, me kontributin e tyre, i ndërtuan tempullin, pranë manastirit të krishterë shenjtore Marene. Besimtarët e Shën Marenes janë të gjithë banorë të Mokrës dhe rrethinave të saj. Kremtimi bëhet më 29-30 korrik.

Kostandini i Madh (272 – 237)

I ati Kostanc dhe e ëma Helena e shenjtë janë figura me rëndësi në historinë botërore. Kostandini i Madh ishte Perandor i Perandorisë Romake (Lindjes dhe Perëndimit), gjatë



Figura e Shenjtorëve Koostandini i Madh dhe Elena gjendet e pikturuar në afresk në hyrje të kishës së Shën Marenës në Llëngë të Pogradecit nga Kostandin Shpataraku, v. 1754

viteve 306-316) ndaloi përndjekjet fetare dhe i hapi rrugë Krishterimit si dhe ndërtoi shumë institucione fetare të krishtere, midis së cilave kishën e Shën Pjetrit në Romë. Kostandinin të Madh i takon merita që dita e diel të jetë ditë pushim në mbarë botën. Figura e shenjtorit Kostandini i Madh dhe e shoqja Helena gjenden të pikturuara në afresket në hyrje të manastirit të Shën Marenës në Llëngë, nga piktori me famë Kostandain Shpataraku.

Shën Jeronimi

Shenjtore i krishterë nga Ilirikumi, teolog dhe një nga "katër doktorët" e mëdhenj në teologji të Kishës Perëndimore, së bashku me Augustinin, Ambrozin dhe Grigorin e Madh. U lind në Stridon të Ilirikut më 347 të e. r. dhe vdiq më 420. Jeronimit papa Damas i kërkoi të përkthente në latinisht Ungjijtë nga dorëshkrimet greke (të Të Shtatëdhjetëve) dhe hebraike. Jeronimi i kushtoi jetën kësaj pune. Teksti ungjillor i përkthyer prej tij, i njohur si Vulgata e Shën Jeronimit, mbijetoi derisa Koncili i Trentit e njohu si versionin zyrtar të Kishës Katolike. Me rëndësi të veçantë historike janë Epistolat e tij, në të cilat përshkruhet gjendja e Ilirisë nën dyndjet barbare etj. Kremton më 30 shtator.

Shën Terini

Shenjtore i krishterë nga Shqipëria i njohur si "Shën Terini i Butrintit". U masakrua në shek. III të e. r. gjatë një vale përndjekjesh kundër të krishterëve, me gjasë në kohën e sundimit të perandorit romak Dec (sund. 249-251 të e. r.). Kremton më 23 prill.

Shën Donati

Shenjtore i krishterë nga Shqipëria. Jetoi në kohën e perandorit Teodos (sund. 379-395 të e. r.), me gjasë në Butrint, duke qenë peshkop i Paramithisë në Epir. I mvishen shumë mrekulli. Vdiq rreth vitit 387 të e. r. Trupin ia dërguan në Kasiopi të Korfuzit më 602 për ta shpëtuar nga një dyndje barbare e asaj kohe. Në Mesjetë ka pasur kult mjaft të përhapur. Kremton më 30 prill.

Shën Nifoni

Shenjtore i krishterë i Kishës Lindore, me origjinë shqiptare. Një pjesë të jetës e kaloi në Arbëri, gjatë periudhës së qendrës dhe luftërave të shqiptarëve kundër pushtimit osman. U takua dhe bashkëpunoi me Gjergj Kastriotin, Skënderbeun, në oborrin e tij, ku tregohet se edhe u dorëzua prift. Më 1486 u bë patriarku ekumenik i 134-t i Kostandinopojës: patriarku i dytë shqiptar në Kon-

standinopojë. Dy vjet më vonë dha dorëheqjen nga kjo detyrë, ndërsa mbas nëntë vjetësh (1497) ktheu në fronin ekumenik ku qëndroi vetëm një vit.

Shenjtët Flor dhe Laur

Flori dhe shoku i tij Lauri, që i quajnë edhe "vëllezër binjakë", si edhe bashkëpunëtorët e tyre Prokul dhe Maksim, u martirizuan në Ilirik ngaqë ndihmuuan në ndërtimin e një kishë të krishterë. Mbas torturave, u hodhën në pus dhe u mbytën. Disa burime lidhin vdekjen e tyre me vendbanimin e lashtë Ulpiana, në jug të Prishtinës, në Kosovë. Kremtojnë më 18 gusht.

Shën Nikodemi (ose Nikodhimi)

Shenjtore shqiptar i Kishës Lindore. Ishte nga Vithkuqi, qendër e njohur kishtarë në shek. XV-XVII. U martirizua në Berat më 1709. Jeta dhe martirizimi i tij përshkruhen në Akoluthinë e botuar për të në Voskopojë, në një kodik të shek. XVIII që ndodhet në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë etj. Kremton më 10 korrik.

Shën Naumi

Shenjtore i krishterë i Kishës Lindore. Ka themeluar manastirin e dëgjuar që mban emrin e tij dhe që sot gjendet në kufirin shqiptaro-maqedon, në brigjet e Liqenit të Ohrit. Kulti i tij u përhap në gjysmën e parë të shek. XVIII me lulëzimin e Voskopojës dhe formimin e Kryepeshkopatës së Ohrit. I mvishen shumë mrekulli dhe manastiri i tij konsiderohej si vend me shpresë shërimi për sëmundje. Figura e tij shihet në afresket e kishave të Voskopojës, të Shpëskës dhe të Vithkuqit. Kremton më 23 dhjetor.

Shën Jan Kukuzeli

Shenjtore i Kishës Lindore, nga Shqipëria. U lind në Durrës me gjasë rreth vitit 1280. Në moshën e djalërisë kishte, siç thuhet, "një zë engjëllor". Ndoci studimet në një shkollë perandorake të Kostandinopojës dhe më pas shërbeu si drejtues kori në kapelën e pallatit perandorak. Muzikant i madh i kohës së vet, u quajt "mjeshër" dhe "burim i dytë i muzikës bizantine" mbas himnografit Shën Roman. Kreu një reformë të madhe në tejkrimin e muzikës bizantine duke përpunuar e hartuar një sistem të vetin të njohur si "sistemi kukuzelik". Figura e tij gjeqdet e pikturuar në afresket e manastirit të Ardenicës. Kremton më 1 tetor.

Nënë Tereza (1910 - 1997)

Nënë Tereza (Anjezë Bojaxhiu e thirrur në familje "Gonxhe"), shqiptare e lindur në Shkup. Hyri në Urdhrin e Motrave Irlandeze të Loretos kur ishte 18 vjeç dhe dha mësim në shkollën misionare për vajza në Kalkuta, ku jetoi nga viti 1936 deri sa vdiq. Më 7 tetor 1950 hapi urdhrin e saj "Misionaret e bamirësisë", që synonte ngjalljen e dashurisë dhe kujdesit për njerëzit e braktisur. Ka marrë disa çmime dhe tituj nderi, si: Çmimi i Paqes Papa Gjoni XXIII (1971), Çmimi Nehru për Mbështetjen e Paqes dhe Mirëkuptimit Ndërkombëtar (1972), si dhe çmimet Templeton dhe Mag-saysay. Më 1979 u nderua me Çmimin Nobel për Paqen për veprën e saj humanitare. Në vitin 1990 vizitoi Shqipërinë dhe një vit më pas hapi këtu një degë të Urdhrit të saj. Pas vdekjes u lumnuar nga Papa Gjoni Pali II. Kremton më 19 tetor.

Nderim e respekt për Refije Pasho Çoçon

Një nënë mokrare, një nënë fisnike e bujare. Në jetën e saj 80-vjeçare prit e përçollti shumë miq, shokë e njerëz të nderuar siç e meritonte dera ku hyri nuse. U lind në fshatin Rrodokal Sipër më 16 mars 1930, në një familje me tradita atdhetare. U martua me të ndjerin Selman Çoço nga fshati Katjel, një burrë fisnik, atdhetar, pjesëmarrës në Luftë, në brigadën e XV-të. Shumë furtuna kanë kaluar mbi të, gëzime e hidhërimi, mjerime e vështirësi. Ajo lindi e rriti 9 fëmijë që e kanë lartësuar emrin e saj, Veziren, Bajramin, Xhevahiren, Iken, Besimin, Rexhepin, Agronin, Lumturijen e Rolandin. Mbas një sëmundje të rëndë, më 12 tetor 2010 nënë Refija u nda nga jeta. Dhimbja ishte e madhe. Për t'i dhënë lamtumirën e fundit kishin ardhur qindra mokratë nga e tërë Mokra, nga qyteti Përrenjasit, nga Rra-



jca Uraka e Kotodeshi, Rashtani e Stravaj, Vërriri e Rrodokali, gjithandej, burra e gra, në shenjë respekti e mirënjohjeje.

Me vdekjen e saj vëllezërit, motrat, fëmijët, nipërit e mbesat humbën njeriun më të dashur të zemrës së tyre. I shprehim ngushëllimet e sinqerta familjes, duke marrë pjesë në hidhërimin dhe duke i ngushëlluar për largimin e nënës së tyre të dashur!

Sami LEKA

Kolazhi "Dasma rrajcare", një arritje e këngëtarit strugan, Skifter Etemi

Nga Zabit CUKU

Shikoni dhe dëgjoni kolazhin dasma Rrajcare e do gjeni realitetin e kultures dhe bukurisë 2000 vjeçare RRAJCARE.

E kam për nder ta them me plot gojen se jam dhe do të mbetem Rrajcar dhe nuk mohoj kurrë vendlindjen, jo atë vënd të bukur jo ata gurët e cukut, jo atë ujë që më rriti me shume mundime dhe sakrifica.

Koha ecën dhe ecën shumë shpejt po vetem se nuk duhet mohuar e mos u lëkundur e tërhequr asnjehere pavarisht vështërsive që ka kaluar krahina e jone në vite të ndryshme të jetës. Disa herë kemi folur e trajtuar shume probleme për këtë zonë, këtë fshat të vjetër, deri për betejën e Domosdovës, apo heroizmat e shumë trimave deri tek Merko Bozha, deri në arritjet e intelektualëve të Rrajcës në Shqipëri, Kanada, në SHBA e tjerë.

Shkak i këtij shkrimi është bërë kolazhi Dasma Rrajcare dhe kujton thënien e bukur të artistit të merituar Sadi HALILI "se në Rrajcë edhe fëmijet në barkun e nënës lëvizin këmbët se duan të kërcëjnë". Unë dhe shumë miq e shokë e shumë dashamirës falenderojnë me gjith zemër organizatorët dhe sponsorizuesin e ketij Kolazhi Dasame Rrajcare. Sapo është marrë vesh nga televizionet dhe me telefonat ka një interes për ta parë dhe dëgjuar, nga shumë dashamirës të Rrajcës e nga shumë krahina të Shqipërisë.

Një miku im nga Mallkastra pasi e kishte parë më njoftoi i pari duke më bravo Zabit ja keni bërë fora me ato vallet dhe atë veshjen e bukur qe pashë në TV Folk-u për Rrajcën tënde.

Një tjetër koleg Selman quhet nga Tirana në telefon duke me thenë se vallja e Rrajcareve është 2000 vjeçare, e kercyer vallen dyshe te burrave ne mallet e Qaf-Thanes dhe të Belicës.

Për ta parë dhe dëgjuar sa më shpejt arrita që më ndihmen e mbesës Elsa ta dixhitalizoj e ta shikoj, disa herë me lot dhe mallgjim atë bukur të veshjes të këngës. Ato pamje burrërore të Destan dhe Nazmi



Karaj me ato thinjat e bardha, nen qylafin e bardhe, atë mashen që trazon e nxit prushin në oxhakun e Rrajcës që ka pjekur dhe djegur aromen e kafesë së mrekullueshme në vite. Ai oxhak që ka pritur ngrohur dhe përcjellë me qindra miq, valltarë e kengetare, ka pritur shume e shume burra që kanë kënduar dhe kërcyer vallen dyshe të thikave. Shikoja me lot dhe emociione pjesen e valles dyshe që kercen Mitat Alla e Destan Karaj tamam si dy djem 20 vjeçarë, dy trima që janë kapur si zinxhiri i pa këputur, dora dorës dhe po zbrasin maleve te larta të Shebenikut në fushen e bukur të Rrajcinës bujare. Nuk mund të lë pa vlerësuar pamjet e atyre vajzave dhe grave valltare e këngëtare. Duke e parë

me një mikun tim nga Mirdita Preng Reçi quhet e ngacmoj dhe i them "shiko se kush janë Rrajcaret, po ai me një gjysëm zëri të mekur me tha, jeni vertet të pa arritshëm, ata janë artistët më të mëdhenj, janë një bukur e veçant, nuk më hiqen sytë, dua të mos mbarojë kurrë kjo

valle "dhe gëlltit me fund gotën e rakisë Rrajcare. Ato pamje të veshjeve, të grave i japin një origjinalitet gruas dhe vajzës Rrajcare. Kërcimi dhe levizja e këmbëve me një uniforme sikur janë një sistem elektrik, është një arritje dhe një vlerë e vetë Rrajcarve.



Vlera dhe arritja e Këngëtarit Strugan, nga Radolishti, Skifter Etemi është e vërtet një realitet, është një zë i mrekullueshëm i traditës së këngës Rrajcare, Etemi ka vite që punon me asamblin Rrajca dhe nga viti në vit rrit vlerat dhe nxjerr në pah traditën dhe kulturën e vjetër Rrajcare. Ky është gjaku që i ka lidhur prej kohësh vendet dhe njerzit tanë të pa ndarë kurrë, pavarisht sistemeve që kanë kaluar.

Janë shumë domethënëse disa vargje të këngës:

...Sot e dymij vjet më parë
Na thërrasin ne Rrajcarë
Kështu më thotë ime gjyshe
Dhe ja nise valles **DYSHE...**

... Është zinxhir pa këputur fare
Dor për dore vallja Rrajcare
Se kështu kemi traditë
Që nga pleqtë edhe fëmijët....

Muzikanti Destan Miftari një rrajcar, brez pas brezi i valles dhe i këngës së gjyshërve, të cilet nuk i mungon mundësia dhe respekti që ka për t'i kujtuar e respektuar. Gjëmima e daulles dhe zërit të bukur të pizgave janë më preket, janë më bukurat se ato janë dëgjuar e do dëgjojnë nga të gjithë dhe në gjithë botën, bjeruni o djem të bukur të rrajcianve.

Krimbi brejtës në radhët e batalionit "Reshit Çollaku"

(vijon nga faqja 5)

Ç'ke me xhaxhi Pilon?

Kjo pyetje nëpërmjet telefonit më është bërë më 18 korrik 1991. Ishte një shaka e tim vëllai me shokë në MMP Dëgjova se lexonin shkrimin tim te "Luftëtari" dhe qeshnin. Këto ditë një telefonatë jo aq e ngjashme me të parën erdhi nga Pogradeci: "Alo Haki, Hakiu je? Po ti sikur anon nga ana jonë, bre?! Hala me shpifjet e Pilos do të na vrisni?". Ky miku imi vjetër, ndoshta ngelur nga të fundit partizanë të Mokrës, shprehu keqardhjen pse kishim vendosur në gazetë mbal-lomën e ish-komisarit të tij. Foli e foli duke thënë se ca plagë nuk duhen ngacmuar. U ndjeva keq. Mbi rëfimet e tij kisha ndërtuar disa shkrime. Më i miri ai "Urani me dy kobure, prej të cilave njëren duhet ta ketë akoma në brez, tjetrën ia hoqën në kohën e Zhulalit për t'ia shitur muzeut amerikan. Përsëri po shkruaj për hatër të tij dhe miqve të mi. Më duket se jam brenda platformës së gazetës sonë "atdhetare, kulturore". Jam brenda atij atdhetarizmi që luftën e merr në raportin me pushtuesin e jo në kryqëzimin e armëve

mes vetes. Do të dëshiroja që shoqëria jonë të ishte një harmoni e tërë. Mokra përbën shembullin më të mirë. Kuvendet e Reshitit lanë gjurmë. Pas tij kovaçi i Korçës i paska fryrë kacekut të luftës së klasave, po aq edhe përçarjes fetare qysh në vitin 1943. Unë e kam "kujtuar" Pilon që në vitet 90-të kur ai ende mbante në xhep mandatin e deputetit të votuar me votat e mokrarëve. Në shënimet e mia botuar te gazeta "Luftëtari", më 21 mars dhe 18 korrik 1991, kushtuar Pojskës së Reshitit, Pilon e kam personazh negativ, në rolin e lepurit në ferrë. Sigurisht nuk e zgjodha për kredo politike, sepse s'kisha menduar e as më ka ngelur merak pse nuk u adaptova në parti të majta e pse nuk aderova në gjirin e partive të djathta. Partia ime më e dashur mbetet Mokra ime. Më pëlqen të marrë frymë lirisht. Për mua filozofia e jetës në demokraci është si festat e Vitit të Ri. Ja, shpirti sikur kërkon të fali edhe atë që për arsye të ndryshme të mban inat. Nëse këto ditë do të mundem të mësoj numrin e telefonit të autorit që më ndoqi me letra anonime prej vitit 1957, natën e fundvitit do t'i telefonoja: "Gëzuar, o njeri!". H.B

